

REPUBLIKË E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE – TIRANE

N<sup>o</sup> 1681 Rep.

N<sup>o</sup> 285 Kol.



**Statuti dhe Akt Themelimi i Shoqërisë “ALBA FASHION” Sh.p.k**



Ne Tirane, sot me date 15.03.2018, perpara meje noteres Artemisa V. Mecaj (Arap), anetare e dhomes se notereve Tirane, me seli “Rr. Durresit Nr. 81” u paraqiten personalisht, shtetasit italianë të cilët më kërkuan redaktimin e Statuti dhe Akt Themelimi i Shoqërisë “ALBA FASHION” Sh.p.k si më poshtë:

1. Z. DINO CASAGRANDE, i biri i Carlo, shtetas italian, lindur më 07/03/1945 në Roncade (TV), Itali dhe banues në Via Tre Ponti, Roncade (TV), Itali, mbajtës i Letërnjoftimit italian Nr. AR3181816, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Z. MICHELE GOBBO, i biri i Costante, shtetas italian, lindur më 25/02/1965 në Treviso (TV), Itali dhe banues në Via Antonio Canova 5/7, Itali mbajtës i Letërnjoftimit italian Nr. AT3793646, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. Z. MAURO MINATO, i biri i Ernesto, shtetas italian, lindur më 12/12/1967 në Roncade (TV), Itali dhe banues në Via Stradazza 18/A, Itali mbajtës i Letërnjoftimit italian Nr. AU9184404, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**KAPITULLI I**

**EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI**

**Neni 1**

**Emri**

- 1.1. Shoqëria do të quhet “ALBA FASHION” Sh.p.k. (Këtu e mëposhtë “Shoqëria”)
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe yulën e saj zyrtare.

Neni 2  
Selia

2.1. Selia e shoqërisë do të jetë në Lezhe Lac LAC Laç, Rruga Kryesore, Ndertese 3 kateshe, Zk nr.1812, me pasuri nr.46/34/1.

Neni 3

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4

**Objekti**



4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Import-eksport, prodhimi dhe tregtimi me pakice dhe shumice i veshjeve ne pergjithesi, per llogari dhe te veten dhe te treteve, me qellim menaxhimin e ndermarrjeve te veta apo te treteve; Gjithashtu, te zhvilloje aktivetete te perpunimit, te projektimit, realizimit te modeleve, prototipeve, kampionareve ne pergjithesi per ndermarrje qe operojne ne sektorin si me siper. Gjithashtu, te krijoje, ta marre persiper dhe/ose te leshoje mandat perfaqesimi dhe koncesione per produkte dhe materiale ne pergjithesi. Ajo mund te veproje si ne emer te vete po ashtu edhe per llogari te te treteve. Shoqeria ne rruge jo paresore dhe krejtesisht te rastesishme per arritjen e objektit te shoqerise dhe jo kundrejt publikut, do te mund te zhvilloje gjithashtu aktivetete te tjera te lidhura me ato me siper te radhitura dhe te permbylle te gjitha veprimet imobiliare dhe te tjera, financiare, tregtare dhe industriale qe jane te nevojshme dhe te dobishme per realizimin e qellimeve te shoqerise, duke perfshire leshimin dhe marrjen e garancive reale dhe personel ne favor te te treteve, gjithashtu te permbushe cdo veprimtari tejter qe ka per objekt arritjen e ketyre qellimeve, duke perfshire blerjen dhe shitjen e inetersave dhe kuotave pjesemarrrese, kuotat, ne shoqeri te tjera, ente, sipermarrje, konsoricume, te themeluara dhe qe do te themelohen, ne Itali dhe ne te gjitha vendet e botes, te njejta sikur te jene te financuara sipas percaktimeve te ligjit.

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR**

**NENI 5**

**Kapitali Themeltar**



Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 3 kuota.

Z. DINO CASAGRANDE, zotëron 73 % (shtatëdhjetë e tre) të kapitalit themeltar të shoqërisë, e barabartë me 1 (një) kuota e barabartë me 73.000 (shtatëdhjetë e tre mijë) lekë.

Z. MICHELE GOBBO, zotëron 15 % (pesëmbëdhjetë) të kapitalit themeltar të shoqërisë, e barabartë me 1 (një) kuota e barabartë me 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Z. MAURO MINATO, zotëron 12 % (dymbëdhjetë) të kapitalit themeltar të shoqërisë, e barabartë me 1 (një) kuota e barabartë me 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.

Kapitali mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimit të asamblese së ortakëve themelues. Kuota e Pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme. Kapitali është teresisht i shlyeshëm dhe i nenshkrueshëm. Çdo kuota i takon e drejta e një vote.

#### NENI 6

Ortaku që ka ndërmend të shesë kuotat e tij teresisht, apo pjesërisht duhet me parë të njoftojë ortakun tjetër të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë. Kete të drejta ortaku duhet ta ushtrojë Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emërin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të afëruara ortaku tjetër të shoqërisë.

#### NENI 7

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme etj të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

#### NENI 8

Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë të shoqërisë.

#### NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur para se ai të largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij.


#### NENI 10

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj.

#### NENI 11

Shoqëria tregtare "ALBA FASHION" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, material ose jo material, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurive së vet tek të tjerët.



Ne Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare "ALBA FASHION" sh.p.k. gezon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.

#### NENI 12

Shoqëria tregtare "ALBA FASHION" sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet qe ortaku kane pasur para se ajo te krijohet.

### KAPITULLI I III

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

#### NENI 13

##### Kompetencat e ortakut

13.1 Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë se saj, duke përfshire edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko financiare ne çdo faze te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te përfaqësueseve ne ketë aktivitet.

13.2 Kane te drejte te tërheqin te gjitha dokumentet kryesore te shoqerise per tre vjetet e fundit

13.3 Kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin pjesen e kapitalit te tyre ne perputhje me kushtet qe i lejon statute dhe ligji.

13.4 Ortaket ne perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin ne fuqi kane, te drejte qe ne te njejten kohe te jene ortake edhe ne shoqeri te tjera.

13.5 Ortaket rezervojne te gjitha te drejtat sipas ligjit Tregtar.


#### NENI 14

Shoqeria do te drejtohet nga administratorët e saj Z. DINO CASAGRANDE, MICHELE GOBBO dhe MAURO MINATO, të cilët së bashku ose veç e veç kanë kompetencat sipas Nenit 15 dhe 16 të këtij statuti, për një periudhë kohore pesë vjeçare.

#### NENI 15

##### Administrimi i shoqërisë

15.1 Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, meqellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakeve.



15.2 Administratori përfaqëson shoqërinë në mardhenie me të tretet si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

15.3 Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të treta për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për detyra kryera gjatë administrimit. Ortaku ka të drejtë të ngrej padi ndaj administratorit.

15.4 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut, kanë të drejtë të veprojnë, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

15.5 Shoqëria administratohet të pakten 1 (një) dhe maksimumi 5 (pesë) administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh.

15.6 Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbussimin e shpenzimeve të bera prej tij për llogari të shoqërisë.


15.7 Kur administrator i shoqërisë rezultojë i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë atëherë ortakët vendosin lidhur me shpërblimin që do t'i jepet atij në fund të vitit financiar.

## NENI 16

### Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta.

- Te mirë administrojë pasurinë e shoqërisë
- Te lidhë marrëdhënie me të tretet Brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët.
- Te zbatojë rregullat e brendshme të shoqërisë
- Te shpërblejë detyrat që i vijnë shoqërisë si pasojë e veprimeve apo mos veprimeve të tij.
- Te paguhet për punën e kryer në bazë të marrëdhënies së bërë midis tij dhe ortakëve.
- Te marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithçka që ai e quan të dobishme për shoqërinë
- Te miratojë planin e llogarive ekonomike pas përfundimit të tyre dhe të paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët
- Te behen propozimet përkatëse ortakut të vetëm kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themelues të shoqërisë.
- Te miratojë aktet normative që përcaktojnë apartet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin e personelin
- Te përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të propozojë ortakëve për krijimin e entiteteve strukturave të ndryshme si filial, degë e epërfaqësi në qytetet të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Te përgatitë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'i paraqesë ortakut për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarë të komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para ortakëve.
- Te sigurojë zbatimin e përpikë të Vendimeve të Ortakëve.
- Te kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ortakët i vetëm i shoqërisë.



**NENI 17**  
**EKSPERTI KONTABEL**

17.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bënë administrator

17.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë

17.3 Ato përgjigjen për demet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

17.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

17.5 Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë në gjini e krushqi deri në shkallen e katert. Po ashtu nuk mund të kryejnë këto detyra përgjegjësit e syrave, filialeve e agjensive.

**KREU III**  
**MARRËDHËNIET E PUNES**  
**NENI 18**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 19**

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 20**

**Sekreti i punës**

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

**KAPITULLI I IV**  
**VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

**NENI 21**

**Viti financiar**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Përjashtimisht Viti I parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të të një viti.

Shoqëria "ALBA FASHION" sh.p.k cakton si Ekspert Kontabël të saj znj. Meri Lika, e cila do të ndjekë të gjitha procedurat që parashikon ligji Shqiptar pranë Tatim-Taksave, Bashkisë, QKB etj.

**NENI 22**

### **Inventari dhe llogarite vjetore.**

Shoqëria do të mbaje një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.  
Në mbylljen e vitit financiar administrator harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogarite vjetore për vitin financiar.

### **NENI 23**

#### **Raportet vjetore**

**23.1** Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.

**23.2** Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

**23.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### **NENI 24.**

#### **Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.**

**24.1** Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit të mëparshëm, hiqet menjëherë një shumë e barabartë me 5 % (pese për qind) e fitimit të destinuar për formimin e fondit rezerve të quajtur "rezerve të domosdoshme".

**24.2** Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrijë 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.

**24.3** Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçante në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

### **NENI 25**

Te ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortakët duke i qëndruar në uljen 5 % që do të destinohet rezervës ligjore.

## **KAPITULLI V**



### **MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

### **NENI 26**

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

### **NENI 27**

**27.1** Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim të sipër".



27.2 Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakeve.

27.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

#### **NENI 28**

Ortaket vendosin mbi rregulshmerine e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortaket mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

#### **NENI 29**

Kur ortaket për shkak të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëriac regjistrohet prej tij.

### **DISPOZITET KALIMTARE**

#### **NENI 30**

##### **Dispozitat e fundit**

30.1 Për të gjitha çeshtjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

30.2 Për efekt të intepretimimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"


30.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

#### **NENI 31**

##### **Gjykata kompetente.**

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në mbështetje të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit" ngarkohet Z. **ALTIN SELMANAJ**, të depozituar Statuti dhe Akt Themelimi i Shoqërisë "ALBA FASHION" Sh.p.k, pranë Qendren Kombëtare të Biznesit, Tiranë.



NENI 32

**Hyrja ne fuqi**

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

Persa me siper u muar prej meje, Noteres, pasi iu lexua ortakëve të Shoqërisë edhe në gjuhën Italiane nga Përkthyesi Alban Dauti, Përkthyes i Miratuar, i Ministrisë së Drejtësisë dhe u gjend ne perputhje me theniet e tyre, ata me vullnet te lire dhe te plote e nenshkruan ne pranine time Statuti dhe Akt Themelimi i Shoqërisë "ALBA FASHION" Sh.p.k të datës 02.02.2018, ndersa une, Noterja e vertetoj ate rregullisht sipas ligjit, 7829, date 01.06.1994, "Per Noterine", (i ndryshuar).

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "ALBA FASHION" sh.p.k.**

DINO CASAGRANDE

CASAGRANDE DINO  
*[Signature]*

MICHELE GOBBO

MICHELE GOBBO  
*[Signature]*

MAURO MINATO

MAURO MINATO  
*[Signature]*

**NOTERE**

*Autentica stamp (mecc)*



*Taksa e pulles u pagua*

*Përktheu: Alban Dauti*

*Alban Dauti*  
**Alban DAUTI**  
Traduttore Giuridico  
Cell: +355682122667  
M: albdauti@hotmail.com